



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 569/22
579/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: nga Kimete Gashi - Kryetare, Agon Ramadani- Anëtar dhe Vedat Poterqoi Antar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "EBK SH.P.K", me seli ne Prizren si dhe ankesës së operatorit ekonomik (GOE) "Nika Pro-ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Projekt", me seli ne Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë vazhdimi i punimeve" me nr. të prokurimit: 214-22-8829-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Punëve të Brendshme, me datë, 17.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- 1. ANULOHET** aktiviteti i prokurimit "Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitisë vazhdimi i punimeve" me nr. të prokurimit: 214-22-8829-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifave së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 05.10.2022 ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi SHFMU ne Pozharan Komuna e Vitisë vazhdimi i punimeve” me nr. të prokurimit: 214-22-8829-5-1-1. AK ka parashikuar hapjen e ofertave me datën 15.09.2022. Kërkesa për ri shqyrtim në AK me datë 10.10.2022, si vendimi për ri shqyrtim nga AK: 12.10.2022.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE me datën 10 tetor 2022 ka parashtruar ankesë në OSHP, “Nika Pro-ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Projekt”, me seli ne Ferizaj.

Poashtu kundër vendimit të AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit, me datën 24 tetorë 2022 ankesë në OSHP ka parashtruar edhe operatori ekonomik “EBK SH.P.K”, me seli ne Prizren.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë , vlera e parashikuar e kontratës: 939 633,44 €.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 07.11.2022 ka rekomanduar që:

- Të aprovohen si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues “Ebk Sh.P.K”,si dhe ankesa e GOE“Nika Pro-ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Projekt”
- Të anulohet njoftimi për dhënie i AK-së.

Përgjigje në Pretendimi nr.1 .

OE” EBK Sh.p.k” me seli në Prizren pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e punëve të brendshme nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të sigurojë mënyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen.

Eksperti thekson se pretendimi i OE ankues nuk qëndron sepse pjesa e goditur në këtë pretendim ka të bëjë me efikasitetin, me transparencën dhe me të drejtën e shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, andaj eksperti konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 .

OE ankues "EBK Sh.p.k", pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e punëve të brendshme nuk e ka respektuar nenin 7 si dhe paragrafin 1 dhe paragrafin 6 të LPP-së ,eksperti shqyrtues sqaron se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Eksperti sqaron se pa u sqaruar plotësisht se tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse dmth fillimisht AK duhet të sigurohet se teknikisht nuk do të të paraqesin problem pajisjet të cilat janë trajtuar si devijime të vogla dhe se disa dokumente të stafit dhe pas pranimit të sqarimeve apo edhe vlerësimit të hapësirave në teren apo edhe të pajisjeve, andaj ky pretendim eksperti mendon se është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3 .

OE ankues "EBK Sh.p.k", pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e punëve të brendshme nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, pretendon vlerësimi nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së si dhe i njëjti pretendon se eliminimi i OE ankues është bërë për këto arsye :

Oferta juaj është e papranueshme për arsyet e poshtë cekura:

1.CCTV-Mertition Tershenjaku nuk e plotëson kërkesën e FDT-se pasi certifikatat e ofruara nuk e përmbushini kërkesën.

2.Në kërkesën teknik i ndërtimtarisë, ju keni ofruar z. Çlirim Krasniqi dhe z. Reshat Krasniqi, nuk e plotësojnë kërkesën e kërkuar ne FDT.

OE ankues, përmes ankesës sqaron se me ofertë kemi ofruar Teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV pra përderisa ne e kemi ofruar teknikun e certifikuar ashtu siç është kërkuar ne D.T.ne e plotësojmë kërkesën e lartcekur si dhe e përmbushim ne tërësi kërkesën e FDT përderisa ne e kemi ofruar teknikun e certifikuar ,atëherë nga ky fakt kuptohet shumë qartë se ne e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit

Eksperti sqaron se certifikatat janë dorëzuar dhe AK për të njëjtat nuk ka dhënë sqarime pse të njëjtat nuk i plotësojnë kërkesat e kërkuara në FDT gjithashtu AK nuk ka kërkuar sqarime nga ana e operatorit ekonomik apo lëshuesit të këtyre certifikatave të cilat nuk i ka pranuar si të tilla, eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Grupi i OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën e FDT-së 9.1&9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht pika 2 e ku është kërku një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Mastar i Ndërtimtarisë, drejtimi-Hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe si dëshmi është kërkuar, Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, me motorizim jo më të vjetër se në tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt me punëdhënësin-kopje. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar.

Po ashtu grupi i OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar si inxhinier të drejtimit Hidroteknik z. Naim Demiri i cili e ka ofruar diplomën me noterizuar në vitin 2019, ku data e noterizimit është në kundërshtim me kërkesën e FDT-së sepse është kërkuar që noterizimi të jetë jo më i vjetër se 3 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, pra përderisa kërkesa është specifikuar shumë qartë se duhet të ofrohet noterizimi jo më i vjetër se tre muaj nga data e publikimit për kontratë, është shumë i qartë fakti se Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se noterizimi i diplomes së ing. të hidros Naim Demiri nuk është bërë brenda afatit të paraparë me NJK dhe me DT ,mirëpo grupi i operatoreve ekonomik në listën e të punësuarve ka edhe Arben Hajrizin inxhinier të Hidros OE i shpallur fitues i ka dy inxhiniera adekuat andaj edhe sikur të kishte vetëm një inxhinier me diplomë të noterizuar jo brenda tre mujorit të paraparë do të ishte devijim i vogël dhe rezultati do ishte i njëjtë, andaj ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Po ashtu,pretendimi i OE ankues se grupi i OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka ofruar dëshmi konkrete për inxhinierin e arkitekturës që ka eksperience në aplikimin e standardeve internacionale. Tek kërkesat e FDT-së 9.1 & 9.2 tek Kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht pika 6. Kërkesë ka qenë "Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitekturës- min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit", dëshmi dokumentare të ofrohet: Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, me noterizim jo më të vjetër se në tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt-kopje. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëmine e kërkuar, duhet te ketë eksperienca ne aplikimin e standardeve internacionale".

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë për inxhinier te arkitekturës ka ofruar znj. Florina Orana - Hoxha për të cilën nuk ka ofruar asnjë dëshmi që e njëjta inxhiniere ka eksperienca në aplikimin e standardeve internacionale.

Eksperti thekson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me pretendimin për Ing. e Diplomuar ose Master të Arkitektuerës sepse OE ka dorëzuar dëshmit për Florida Orana- Hoxha e cila e plotëson kriteri e paraparë me NJK dhe DT, e njëjta ka dorëzuar shumë referenca si nga IKSHPK, Komuna e Kaçanikut dhe të tjera si dhe projektin ideor për shkollën fillore katër klasëshe për 30 lokacione të Kosovës, donacion nga UNICEF, andaj pretendimi nuk është i bazuar.

OE ankues pretendon se :

Grupi i OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson as kërkesën tjetër të FDTsë tek 9.1 & 9.2 tek Kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht pika 12 e ku është kërkuar : *"12. Operatori ekonomik duhet te ofroje si dëshmi se posedon këto pajisje Eskvator 3.5- 4.5 ton Cilinder 3-5 ton Greder 5.2-8 ton Damper 2-5 ton, dëshmi dokumentare është kërkuar : Listën e pajisjeve origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Kopjen e librezave ose DUD doganor qe I ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve — me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë. Të gjitha makineritë të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit".*

Në ofertën e dorëzuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk figuron askund Cilindri me tonazhe 3-5 ton si dhe Grejderin më tonazhin 2-8 ton. Pra përderisa OE i rekomanduar për kontratë

nuk i ka prezantuar pajisjet e lartcekura me tonazhin e kërkuar është shumë i qartë fakti se i njëjti është OE i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, pasi që nuk mund dhe nuk duhet të rekomandohet për kontratë një OE i cili nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Autoriteti Kontraktues me vendimin e datës 12.10.2022 është përgjigjur dhe e ka theksuar se Grederi është më i madh se sa është kërkuar me DT dhe ka shtuar se ne UOPP faqe 59 AK duhet cekur vetëm minimumin e kërkesave dhe si rrjedhojë OE janë të përgjegjshëm duke marr parasysh edhe çmimin ma te lirë bazuar ne nenin 59.4 të LPP-së me të drejtë e ka rekomanduar për kontratë duke marr parasysh nenin 1 të LPP-së .

Eksperti shqyrtues sqaron se tonazha e Cilindrit dhe tonazha e Grejderit nuk përputhen me tonazhen e paraparë me NJK dhe DT, mirëpo AK deri më tani nuk ka dhanë dëshmi se edhe me këtë tonazh nuk do të ketë problem për ekzekutimin e kontratës nëse eventualisht i jepet grupit të OE të shpallur fitues në rastin konkret për ta trajtuar si devijim të vogël siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së ne duhet të që teknikisht të sigurohemi se a paraqesin problem pajisjet për ekzekutimin e kontratës ,pas pranimit të sqarimeve apo edhe vlerësimit të hapësirës në teren ku duhet të kryhet puna, AK vendos se mospërputhja e tonazhes është apo jo devijim i vogël e që ne rast se nuk ka probleme për kryerjen e punëve i njëjti mundë të trajtohet si devijim i vogël sepse ndërlidhet nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që është oferta me çmimin më të lirë, pra ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4 .

OE ankues “EBR Sh.p.k”,- pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së , dhe neni 28 i RRUOPP.

Eksperti sqaron se pretendimi është pjesërisht i bazuar sipas arsyeve të përmendura në përgjigjen me numër 3 .

Përgjigje në Pretendimi nr.5 dhe 6.

OE ankues “EBK Sh.p.k”, pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 69 dhe 72 të LPP-së ,eksperti shqyrtues thekson se OE ankues vetëm sipërfaqësisht e ka përmendur nenin 69 të LPP-ë pa e theksuar se qka nuk ishte ne harmoni me këtë dispozitë ,ndërsa sa i përket nenit 72 të LPP-së OE ankues pretendon se lidhur me stafin për te cilin është eliminuar ka pasur mundësi që bazuar ne nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkojen informata nga lëshuesi i certifikatës kontestuese për CCTV të prezantuar me rastin e ofertimit, Eksperti konstatkon se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi pn,

OE ankues “EBK Sh.p.k”, pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 108/A të LPP-së

OE ankues pretendon , se përderisa AK nuk e ka arsyetuar vendimin e saj e njëjti ka bërë shkelje të dispozitave te LPP-së përmend paragrafin 9 refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim .

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron pasi që AK bazuar në volumin e madh të kërkesave për rishqyrtim dhe kronologjisë së pretendimeve ankimore, ka mundur edhe mos të jap përgjigjeje ne ndonjë pretendim direkt, por i njëjti pretendim ka qenë të dy apo ma tepër kërkesa për rishqyrtim dhe të njëjtat përgjigjeje janë dhënë përnjëherë me një vendim që do të thotë se ka pranuar përgjigjeje me të njëjtin vendim, si dhe të përgjigjej, lidhur me eliminimin AK nuk u lëshua ma tepër se sa e ka konstatuar ne Letrën standarde por prapë ishte një përgjigjeje, kurse mënyra e arsytimit është relative nga secili zyrtar .

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues GOE “Nika Pro-Ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART Projekt me seli ne Ferizaj.

Përgjigje në Pretendimi nr.1 .

OE” Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART PROJECT -Ferizaj - pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së ,

Eksperti shqyrtues sqaron se ndër të tjera qellim i këtij neni është të sigurojë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen.

Pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e nenin1 të LPP-së, shih pretendimin :

Autoriteti kontraktues duhet ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk qëndron, sepse pjesa e goditur me këtë pretendim ka të bëjë me efikasitetin, me transparencën dhe më të drejtën e shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, pra se sa i përket këtij pretendimi gjithçka ishte transparente, dhe në harmoni me të drejtën dhe mënyrën e shfrytëzimit të fondeve publike, sepse AK ka shpallur fitues OE i cili ka ofertuar me çmim më të lirë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 .

OE ankues “Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART Project” pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së.

Eksperti sqaron se ndër të tjera qellim i këtij neni është të respektohet ekonomiciteti dhe efikasiteti ku te gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike ,njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit .

Përgjigje në Pretendimi nr.3 .

OE ankues “Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Project”, ne ankesën pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se ndër të tjera qëllim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e paragrafi 1 dhe paragrafi 6 të nenin 7 të LPP-së, “

Nuk është respektuar edhe nenin 7 të LPP-së ,duke na diskriminuar neve si OE edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore”.

Sa i përket pretendimit lidhur me paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së lidhur me eliminimin e OE ankues eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i bazuar pasi që pa u sqaruar plotësisht se tenderi i zgjedhur i shpallur fitues të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse ,d.m.th. fillimisht AK duhet të sigurohet se teknikisht nuk do të paraqesin problem pajisjet të cilat janë trajtuar si devijime te vogla, pas pranimit të sqarimeve dhe vlerësimit të hapësirës në teren, apo edhe të pajisjeve në selinë e operatorit ekonomik të vendos për këto devijime.

Përgjigje në Pretendimi nr.4.

OE ankues “Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Project”, pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se qëllim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit,

Po ashtu OE ankues se vlerësimi nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe i njëjti sqaron se eliminimi i OE ankues është bërë padrejtësisht për këto arsye :

1. Njeri anëtar i Konsorciumit tuaj ka deklaruar se është pjesë edhe e një grupi tjetër nga oferta e paraqitur për këtë AP.
2. Gjithashtu ju keni dorëzuar një pames jo standarde-e cila pames nuk ka qen ne sistemin e-prokurimit, ne ofertën e juaj financiare edhe pse nuk ndryshon ne kalkulimin e paramanës, Oferta juaj është administrativisht e pa përgjegjshme.

Sa i përket pretendimit të parë kjo është e rregulluar me paragrafin 2 të nenit 71 të LPP-së

2.Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrijë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast se një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm,

ndërsa paragrafit 1 i nenit 72 të LPP-së lidhur me dokumente dhe informacione shtesë, ndërlidhet me pretendimin e OE i cili pretendon se gabimisht ka mbetur emri i një kompanie tjetër për këtë qështje shihë dispoziten :

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Ndërsa në nenin 39 të RUOPP i cili lidhur me deklaratat e konzorciumit e rregullon në këtë mënyrë: Mungon deklarata e qartë ku të gjithë antarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës-mund të kërkohen informata shtesë .

Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes – Mund të kërkohen informata sqaruese

Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë antarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës-Mund të kërkohen informata shtesë

Eksperti shqyrtues sqaron se në tri deklaratat e konzorciumit në numër rendor I figuron emri i një operatori ekonomik tjetër në të njëjtën figuron edhe nr i regjistrimit të biznesit dhe emri i përfaqësuesit të asaj kompanie e cila është pjesë edhe e një grupi tjetër në këtë aktivitet të prokurimit, dispozitat e LPP-së japin kuptime të ndryshme, sepse paragrafi 2 i nenit 71 në rast se një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm, ndërsa OE pretendon se ka ndodhë gabim teknik.

Në ekzaminimin e tërësishëm të dokumentacionit ka prova të mjaftueshme se gabimisht ka mbetur emri i një kompanie tjetër mirëpo pavarësisht kësaj kjo dispozitë e ligjit e eliminon nga gara, ndërsa paragrafit 1 të nenit 72 e lejon kërkimin e informatave shtesë kur dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ndërsa në nenin 39 të RRUOPP lidhur me deklaratat e konzorciumit e rregullon çështjen kur mungon deklarata.

Pra eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim është i pa bazuar për deri sa dispozitat e LPP-së, njëra e eliminon nga gara, kurse tjetra lejon kërkimin e informatave shtesë gjatë procesit të vlerësimit, ndërsa RRUOPP nuk e sqaron rastin konkrete, por vetëm kur mungojnë deklaratat ,si dhe duke pasur parasysh gjendjen faktike, përderisa nuk kemi ndonjë tjetër informatë nga ligjvënësi, konsiderojë se me të drejtë autoriteti kontraktues ja ka falur besimin dispozitës e cila e eliminon nga gara OE ankues.

Sa i përket pretendimit tjetër për eliminimin e OE ankues lidhur me paramasën jo standarde-e cila paramasë nuk ka qenë në sistemin e- prokurimit, në ofertën e juaj financiare edhe pse nuk ndryshon në kalkulimin e paramasës, pasi shqyrtues vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i bazuar sepse kjo mund edhe të trajtohet si devijim i vogël siç parashihet në paragrafi 4 të nenit 59 të LPP-së , pasi që edhe AK e ka konstatuar se edhe me kalkulime nuk ka ndryshim me paramasën e paraparë nga autoriteti kontraktues.

Pretendimi i OE ankues, lidhur me stafin e Grupin e Operatorit Ekonomik të shpallur fitues është i pa përgjegjshëm për këto arsye:

Në dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, është kërkuar:

“Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitekturës- min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ndërsa si dëshmi dokumentare është kërku Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, me noterizim jo më të vjetër se në tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt-kopje. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëmin e kërkuar, duhet të ketë eksperiencë në aplikimin e standardeve internacionale.

I njëjti OE në lidhje me kërkesën e lartcekur, ka prezantuar dokumentet për znj. Florina Hoxha, mirëpo nuk janë prezantuar dëshmi se ka eksperiencë në lëmine e kërkuar në aplikimin e standardeve internacionale, prandaj nuk përmbushet kërkesa e dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me pretendimin për Ing. e Diplomuar ose Master e Arkitektures sepse OE ka dorëzuar dëshmitë për Florida Orana-Hoxha e cila i plotëson kriterin e paraparë me NJK dhe DT e njëjta ka dorëzuar shumë referenca si nga IKSHPK ,Komuna e Kaçanikut dhe shumë të tjera si dhe projektin Ideor për shkollën fillore katër klasëshe për 30 lokacione të Kosovës, donacion nga UNICEF- pasi që e njëjta ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për përvojën e saj në punët profesionale .

Pretendimi i OE ankues :

OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën FDT-së ku është kërkuar: *Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimitarisë, drejtimi-Hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërku : 2. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, me noterizim jo më të vjetër se në tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt me punëdhënësin-kopje. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar”*

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar si inxhinier të drejtimit Hidroteknik z. Naim Demiri i cili e ka prezantuar diplomën me motorizim të vitit 2019 , që i bie se data e noterizimit të diplomës është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit sepse është kërkuar që noterizimi të jetë jo më i vjetër se tre muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Eksperti sqaron se noterizimi i diplomes së ing. të hidros Naim Demiri nuk është bërë brenda afatit të paraparë me NJK dhe me DT .mirëpo grupi i operatoreve ekonomik në listën e të punësuarve ka edhe Arben Hajrizi ingjnier të Hidros, d.m.th. nga AK është kërkuar një ing. OE i shpallur fitues i ka dy ingjiniera adekuat andaj edhe sikur te kishte vetëm një ingjnier me diplomë të noterizuar jo brenda tre mujorit të paraparë do të ishte devijim i vogël dhe rezultati do ishte i njëjtë, andaj edhe pretendimi i OE ankues është i pa bazuar .

Pretendimi i OE ankues :

Në dosjes së tenderit, ku kërkesë ka qenë një teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Certifikatat dëshminë e kualifikimit për CCTV kopje, CV kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt va lidë me punëdhënësin-Kopje".

I njëjti OE për kërkesën e lartcekur në ofertë ka prezantuar dëshmi për z. Bujar Morina, por që këto dëshmi nuk janë ofruar komform kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që nuk është ofruara certifikata e kërkuar që e vërteton faktin se i njëjti është i kualifikuar për CCTV,po ashtu për të njëjtin, janë prezantuar edhe disa certifikata të cilat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe po ashtu të njëjtat certifikatat janë pa validitet, pasi që ato janë lëshuar në vitin 2020 dhe janë validë vetëm dy vite, përveç se disa prej certifikatave të ofruara janë pa validitet, të tjerat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Për deri sa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar certifikatën me kualifikimin CCTV, është i qartë fakti se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Sa i për këtë këtij pretendimi eksperti shqyrtues sqaron se, z. Bujar Morina si dëshmi ka sjellë CV kontratën e punës Diplomën e bachelorit të shkencave kompjuterike-ingjineri ,ka sjellë edhe disa certifikatë por të njëjtat nuk shkruan saktësisht CCTV ,por për të njëjtat mundë të kërkohen ose gjatë procesit eventualisht të mbajtjes së seancës apo të rivlerësimit të kërkohen sqarime për të njëjtat certifikata, andaj eksperti shqyrtues këtë pretendim të OE ankues e vlerëson si pjesërisht të bazuar.

Pretendimi i OE ankues :

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit: *Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të paraqes se ka ne dispozicion një ekspert për instalimin e sistemeve BMS", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërku " Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për instalim dhe startup të BMS - Kopje , kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin –kopje"*

I njëjti operator ekonomik rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se në ofertë ka prezantuar znj. Jasna Vasilevska, e cila nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, pasi që nuk figuron asnjë dëshmi se e njëjta është e certifikuar për instalimin e sistemeve BMS. Për të njëjtë nuk janë prezantuar certifikatat sipas kërkesës së lartcekur dhe si të tilla këto dëshmi nuk janë ofruar komform kërkesës së lartcekur, andaj nga ky fakt vërtetohet se njëjti OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar disa certifikata për të njëjtën mirëpo që certifikatat e prezantuar nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim të OE ankues sqaron se, znj. Jasna Vesileveska si dëshmi ka sjellë CV kontratën e punës Certifikatën nga Schneider O Electric, por të njëjtat nuk shkruan saktësisht BMS, por për të njëjtat mund të kërkohen ose gjatë procesit eventualisht të mbajtjes së seancës te sqarohet apo të rivlerësimit të kërkohen sqarime për të njëjtën, andaj edhe pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

OE ankues pretendon se :

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën "Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat e pajisjeve sportive ose standardet", dëshmia e kërkuar dokumentare "Certifikata e prodhuesit sipas standardit ISO 9001 për produktet për pajisjet e sportive dhe FSC me ISO standard për materialet e druri".

OE i rekomanduar për kontratë për kërkesën e lartcekur ka prezantuar një autorizim i cili është i lëshuar nga kompania Galanteria SH.P.K., për OE të rekomanduar për kontratë, ku shkruan se autorizohet AAG Project që të ofertoj ndie produktet e Galanteria SHPK, për këtë aktivitet të prokurimit. Ky autorizim nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh për faktin se nuk është i lëshuar nga ana e prodhuesit (The Company Compotek SRL), mirëpo nga kompania Galanteria SHPK e cila nuk është kompetente për lëshimin e autorizimeve.

Në autorizimin e prezantuar në mes të prodhuesit dhe Galanteria SHPK shkruan: Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përfaqësoj kompaninë "Compotek" në Kosovë, si e vetmja në Kosovë tregtimin e mallrave të këtij biznesi.

Në marrëveshjen e bashkangjitur nga OE i rekomanduar në ofertë askund nuk figuron se kompania "Galanteria" është e autorizuar që të lëshon autorizime në emër të prodhuesit për produktet për të cilat ka marrëveshje Galanteria SHPK dhe prodhuesi i lartcekur.

Po ashtu OE rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar dëshmi për standardin ISO 9001 për produktet për pajisjet sportive, pra edhe në këtë rast nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit. Përderisa nuk është ofruar dëshmia për ISO standardin e lartcekur, atëherë kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar komfor kërkesës së dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij e ka sqaruar se ISO 9001:2015 e njëjta nuk gjendet në ofertën e OE me rastin e ofertimit por e njëjta gjendet në platformën e e-prokurimit e cila ishte kërkuar gjatë procedurës së vlerësimit bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ndërsa sa i përket autorizimit i njëjti nuk ishte kërkuar me NJK dhe me DT dhe si i tillë nuk ka qenë e nevojshme as të dorëzohet andaj edhe këto dy pretendime të OE ankues janë të pa bazuara.

Po ashtu OE ankues pajtohet me arsyet e eliminimit për grupin e : OE edhe për grupin e OE ;Global Holding shpk. dhe grupin EBK shpk, por i njëjti pretendon se ka edhe disa kritere që nuk i plotësojnë këta ofertues.

Eksperti shqyrtues sqaron se të njëjtat nuk ndikojnë në rezultatin me që janë trajtuar si OE të eliminuar, andaj nuk është lëshuar në sqarimet tjera lidhur me këtë pretendim.

OE ankues pretendon se: OE "Termomontimi Regja", me seli në Prishtinë nuk i ka plotësuar kriteret parapara me NJK dhe DT për tu shpallur i pa suksesshëm këtë pjesërisht e ka pranuar AK me rastin e përgjigjes, ku e ka trajtuar kërkesën si pjesërisht të bazuar, por se AK e ka konsideruar se nuk e ndryshon rezultatin fillestar dhe si rrjedhojë nuk ka kërkuar informacion shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së ,andaj i njëjti pretendim është i pa bazuar .

OE ankues pretendon se :

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar:” *Operatori ekonomik duhet të ofrojë si dëshmi se posedon këto pajisje Eskvator 3.5-4.5 ton Cilinder 3-5 ton Greder 5.2-6.2 ton Damper 2-5 ton si dëshmi është kërkuar “Listen e pajisjeve origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Kopjen e librezave ose DUD doganor që I ka në pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik-kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë. Të gjitha makineritë të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit”.*

Pra sipas OE ankues OE rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se:

Për pajisjet ekskavator 3,5-4.5 ton, Cilindër 3-5 ton, Damper 2-5 ton, ku si dëshmi është kërkuar (Dudë / Librezë), OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas kërkesës së lartcekur, pasi që ka prezantuar vetëm fatura, ndërsa është kërkuar që të prezantohet kopja e librezave ose DUD. OE rekomanduar për kontratë i ka prezantuar edhe marrëveshje për marrjen me qira të makinerisë, mirëpo edhe në rast se pajisjet merren me qera është dashur të prezantohen dëshmitë e kërkuara siç janë dudi dhe librezat si dëshmi të pronësisë.

Faturat e prezantuara për pajisjet nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, sepse janë kërkuar dudë ose librezë kopje dhe jo fatura, andaj OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën e lartcekur dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti prokurimit

Po ashtu OE i rekomanduar për Grejderin 2-8 ton ka prezantuar një dudë doganor, i cili kur analizohet shihet qartë se grejderi i prezantuar nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit pasi që është me pesh 10 ton, ndërsa kërkesa ka qenë e qartë se duhet të prezantohet me tonazhe 2-8 ton.

Eksperti shqyrtues sqaron se tonazha e Cilindrit dhe tonazha e Grejderit nuk përputhen me tonazhen e paraparë me DT ,mirëpo AK deri më tani nuk ka dhanë sqarime, dëshmi se edhe me këtë tonazh nuk do të ketë problem për ekzekutimin e kontratës nëse eventualisht i jepet grupit të OE të shpallur fitues ,në rastin konkret për ta trajtuar si devijim të vogël siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së nëse duhet të që teknikisht të sigurohemi se a paraqesin problem pajisjet për ekzekutimin e kontratës ,pas pranimit të sqarimeve si edhe vlerësimit të hapësirës në teren ku duhet të kryhet puna, AK duhet vendosë se mospërputhja e tonazhës është apo jo devijim i vogël, e që në rast se nuk ka probleme për kryerjen e punëve i njëjti mund të trajtohet si devijim i vogël sepse ndërlihet me nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që është oferta me çmimin më të lirë, andaj eksperti shqyrtues konstatoj se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5.

OE ankues “Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Project me seli ne Ferizaj pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së , eksperti shqyrtues sqaron se qëllim i këtij neni vendosja e kriterit dhe se kriter në DT ishte të shpërblehet me kontratë Ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, sipas arsyeve të përmendura në përgjigjejen me numër katër (4) paraprahe.

Përgjigje në Pretendimi nr.6.dhe 7

OE ankues “Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Project”, në ankesën e tij drejtuar OSHP-së po ashtu pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 69 dhe 72 të LPP-së .

Sa i për këtë këtij pretendimi eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues vetëm sipërfaqësisht e ka përmendur nenin 69 dhe 72 të LPP pa e theksuar se qka nuk ishte ne harmoni me këto dispozita, andaj,eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi pa nr.

OE ankues “Nika Pro-ing shpk & N.N.P.T Engineering & N.N.P. Art Project” pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka respektuar nenin 108/A të LPP-së, po ashtu OE ankues pretendon se përderisa AK nuk e ka arsyetuar vendimin e saj e njëjti ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së përmend paragrafin 9 refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim.

Me pas OE ankues në ankesën e tij pretendon se me kërkesën për rishqyrtim përveç ofertës të rekomanduar për kontratë ka pasur edhe pretendime edhe për grupin e OE “Global Holding shpk”, për grupin “EBK shpk”,si dhe për e OE “Termomontimi Regja” dhe ka pranuar përgjigjeje vetëm për OE “Termomontimin Regja” ku e ka trajtuar kërkesën si pjesërisht të bazuar por se AK e ka konsideruar se nuk e ndryshon rezultatin fillestar dhe si rrjedhojë nuk ka kërkuar informacion shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së

Eksperti sqaron se për : OE “Termomontimi Regja” ,zona industriale Prishtinë i cili ishte i vetmi OE i pa suksesshëm ,AK ishte pajtuar pjesërisht me pretendimet ankimore dhe kishte konstatuar se nuk ndikon në rezultatin fillestar, ndërsa dy OE apo grupet e operatorëve tjerë veq ishin shpallur të eliminuar që do të thotë se rezultati do ishte i njëjtë ,andaj eksperti shqyrtues këtë pretendim OE ankues e konsideron si të pa bazuar.

Konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/ 2020 e datës 03. 03. 2022 (e amandamentuar), paneli shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë dhe sqaron :

Përgjigje lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga OE Ankues “EBK SH.P.K”, me seli ne Prizren.

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues OE Ankues “EBK SH.P.K”, me seli ne Prizren me të cilin pretendon se AK nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, duke pretenduar se

vlerësimi nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së si dhe i njëjti pretendon se eliminimi i OE ankues është bërë për këto arsye :

- a) CCTV-Meriton Tershenjaku nuk e plotëson kërkesën e FDT-se pasi certifikatat e ofruara nuk e përmbushin kërkesën.

Këtë pretendim ankimor, PSH e klasifikon si të pabazuar për faktin se OE i ankues nuk plotëson këtë kërkesë të vendosur të DT, andaj me qenë se kjo dëshmi kërkohet në DT tek kapaciteti teknik dhe profesional në DT, që si të tilla janë kritere kualifikuese, PSH konstaton se OE ankues në këtë rast nuk e ka përmbushur atë dhe si i tillë e bënë të papërgjegjshëm OE ankues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Lidhur me pretendimet tjera ankimore ndaj OE "EBK SH.P.K" Paneli Shqyrtues konstaton se nuk do të ndalet në trajtimin e tyre për shkak se kjo është pika kyçe e cila përcakton rrjedhën e vendim-marrjes përfundimtare.

Përgjigje lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues GOE "Nika Pro-Ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART Projekt me seli ne Ferizaj;

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues "GOE "Nika Pro-Ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART Projekt me seli ne Ferizaj" ku pretendon se AK nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së duke pretenduar se eliminimi i OE ankues është bërë padrejtësisht për këto arsye

- a) Njeri anëtar i Konsorciumit tuaj ka deklaruar se është pjesë edhe e një grupi tjetër nga oferta e paraqitur për këtë AP

Paneli Shqyrtues konstaton se në trajtimin e kësaj ankese do të ndalet tek pretendimi ankimor 4, si pikë kyçe e cila përcakton rrjedhën e vendim-marrjes përfundimtare.

Ky pretendim ankimor,sa i përketë pikës a). të eliminimit të OE ankues, PSH sqaron se është e rregulluar me dispozita ligjore sipas par. 2 të nenit 71 të LPP-së "Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrorë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast se një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm" Lidhur me këtë pretendim PSH vlerëson se AK nuk ka pasur mbështetje ligjore të kërkoj sqarime shtesë , andaj PSH konstaton se ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë e bënë të papërgjegjshëm OE ankues lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues kundër GOE të rekomanduar duke pretenduar se GOE i rekomanduar nuk ka plotësuar kriteret sipas dosjes së tenderit, ku kërkesë ka qenë një teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Certifikatat dëshminë e kualifikimit për CCTV kopje, CV kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valid me punëdhënësin-Kopje", duke pretenduar se GOE për kërkesën e lartcekur në ofertë ka prezantuar dëshmi për z. Bujar Morina, por që këto dëshmi nuk janë ofruar komform kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që nuk është ofruara certifikata e kërkuar që e vërteton faktin se i njëjti është i kualifikuar për CCTV, po ashtu për të njëjtin, janë prezantuar edhe disa certifikata të cilat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe po ashtu të njëjtat certifikatat janë pa validitet, pasi që ato

janë lëshuar në vitin 2020 dhe janë validë vetëm dy vite, përveç se disa prej certifikatave të ofruara janë pa validitet, të tjerat nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, PSH pretendim ankimor e klasifikon si të bazuar për faktin se OE i rekomanduar nuk plotëson këtë kërkesë të vendosur të DT, andaj me qenë se kjo dëshmi kërkohet në DT tek kapaciteti teknik dhe profesional në DT, që si të tilla janë kritere kualifikuese, andaj PSH konstaton se ky pretendim është i bazuar dhe si i tillë e bënë të papërgjegjshëm OE rekomanduar lidhur me këtë aktivitetin të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues kundër GOE “Termomontimi” duke pretenduar se i njëjti është i papërgjegjshëm për faktin se nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit tek kërkesa “ Operatori ekonomik ose grupi operatorëve ekonomik duhet të paraqes se ka në dispozicion një ekspert për instalimin e sistemeve BMS” si dëshmi dokumentare është kërkuar “ Certifikatat – dëshminë e kualifikimit për instalim dhe startup BMS...” PSH vlerëson se GOE “ Termomimi në ofertë ka prezentuar Dardan Hajdarin për të cilin ka prezentuar disa certifikata por të njëjtat nuk janë konform kërkesave të vendosura në DT, andaj PSH konstaton se ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë e bënë të papërgjegjshëm GOE Termomontimi lidhur me këtë aktivitetin të prokurimit.

Përgjigje lidhur me pretendimet ankimore kundërdrejtë GOE të rekomanduar të parashtruara nga GOE “Nika Pro-Ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART Projekt me seli ne Ferizaj, dhe GOE “Nika Pro-Ing& N.N.P.T Engineering & N.N.P. ART Projekt me seli ne Ferizaj.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara kundërdrejtë GOE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se nuk e plotëson kërkesën të FDTsë tek 9.1 & 9.2 tek Kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht pika 12 e ku është kërkuar : "12. Operatori ekonomik duhet te ofroje si dëshmi se posedon këto pajisje Eskvator 3.5- 4.5 ton Cilinder 3-5 ton Greder 5.2-8 ton Damper 2-5 ton, dëshmi dokumentare është kërkuar : Listën e pajisjeve origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Kopjen e librezave ose DUD doganor qe i ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve — me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë. Të gjitha makineritë të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit". PSH lidhur me pretendimin ankimor konstaton se GOE i rekomanduar sa i përket kërkesës së vendosur në DT për Grejderin 2-8 ton ka prezantuar një dudë doganor, i cili vlerësohet se nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit pasi që është me pesh 10 ton, andaj PSH këtë pretendim ankimor e klasifikon si të bazuar, se OE i rekomanduar nuk atë dhe si i tillë e bënë të papërgjegjshëm OE të rekomanduar lidhur me këtë aktivitetin të prokurimit.

Paneli shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit vlerëson se AK gjatë procedurës së vlerësimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të nenit 7 dhe nenit 59, të LPP-së.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Ministria e Punëve të Brendshme
- 1x1 OE-ve ankues
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues

Kimete GASHI

